



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183, E-mail: rektorati@uni-pr.edu, www.uni-pr.edu


Këshilli Botues

Nr. Prot.: 3/720  
Datë: 22 / 11 / 2021

Duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas Rregullores për Publikimet e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Nr. Prot. 2/283 dt. 03.10.2013, dhe me qëllim të sqarimit për procedurat e botimit dhe ribotimit të teksteve mësimore universitare dhe publikimeve të tjera nga stafi i rregullt akademik i UP-së, Këshilli Botues ka përgatitur këtë

**UDHËZUES PËR APLIKIM PËR LEJE BOTIMI**

1. Kërkesa për botim i autorit/bashkautorëve, i bëhet Këshillit të Fakultetit me propozimin për emërimin e tre recensentëve të fushës përkatëse dhe një redaktori profesional.
2. Në kërkesë të specifikohet lloji i publikimit: tekst universitar, monografi dhe publikime të tjera të veçanta me përmbajtje të karakterit profesional, shkencor, letrar, artistik dhe informativ.
3. Këshilli botues shqyrton dhe lejon botimin e publikimeve në bazë të pëlqimit me shkrim të Këshillit të Fakultetit, së paku dy recensentëve të fushës përkatëse dhe redaktorit profesional.
4. Publikimet duhet të përmbajnë stemën dhe emrin e Universitetit dhe Fakultetit, emrin dhe mbiemrin e autorit/autorëve (pa thirrje akademike), titullin e tekstit.
5. Nuk duhet të ketë devijime të formës dhe përmbajtjes së publikimit nga procesi fillestar i aplikimit e deri në botimin përfundimtar të tij.
6. Dorëshkrimi duhet të jetë i shtypur në letër (me lidhje të butë) dhe në version elektronik origjinal (World, LaTeX etj.) dhe PDF (i radhitur në kompjuter).
7. Teksti duhet të ketë ballinën e përzgjedhur nga këshilli botues, sipas specifikave si më poshtë: ballina është e dizajnuar me softuerët e Adobe Creative Pack dhe për dizajn të saj janë përdorur dy ngjyra: e kuqe (Red BS UltraMix® All-Pro™ Pantone® Color System - 9208) dhe e zeza (Pantone Black C). Fonti i përdorur është Helvetica dhe Book Antiqua. Formatimi është B5 (250x176), ndërsa shtypi duhet të realizohet në formatin B4+. Letra në të cilën duhet të shtypet ballina duhet të jetë e tipit PPR1-350 gr/m<sup>2</sup>, e llojit matt dhe duhet të jetë e laminuar me varnish llak.
8. Universiteti i Prishtinës, aktualisht nuk ka mundësi të financojë botimin e publikimeve.

Prof. dr. Kurtesh Sherifi  
  
Kryesues i Këshillit

